

**TOMOR OSMANI**

**SHTYPI SHQIPTAR PËR NJËSIMIN E ALFABETIT  
TË SHQIPES (1888-1908)**

Shtypi shqiptar pas Lidhjes Shqiptare të Prizrenit, veçanërisht në vitet e fundit të shek. XIX njeh gjallërim të madh. Por duhet të theksojmë se në kë të periudhë kërkohej me ngut që çështja e njësimimit të alfabetit të merrte zgjidhje të menjëhershme. Kishin kaluar më se tre shekuj nga botimi i librit të parë dhe ky problem ende nuk kishte marrë udhë. Gazeta “Kombi”, më 28 mars 1907 shkruante: “*Sado që jemi të varfër e që na ndjek qeveria dhe s’na lë të çelim mësonjëtoje, gjuha shqipe edhe nga gurët e rrugëve do të shkruhet e do të këndohet.*”<sup>1</sup> Kjo që diviza që do t’i udhëhiqte patriotët shqiptarë, kryesisht në gjysmën e dytë të shek. XIX dhe në vitet e para të shek. XX.

Shtypi shqiptar u paraprin përgatitjeve për zgjidhjen e kësaj çështjeje. Lindin organe dhe fletore të reja, si në Rumani, Bullgari, Itali, Egjipt, Amerikë, në arbëreshët e Italisë etj. Shkrimet e këtyre viteve në kë to vende paraqisnin mjaft interes, se aty pasqyroheshin mendime konvergjente e divergjente, bëheshin propozime konkrete, ndërmerreshin iniciativa dhe marrëveshje dhe të gjithë kishin një objeksion: *zgjidhjen e alfabetit të përbashkët të shqipes*. Gjithashtu në kë to shkrime bëhen vlerësime dhe kritika për sistemet shkrimore të përdorura, duke kërkuar që fillimisht të pakësoheshin ndryshimet në mes varianteve për të kaluar pastaj në njësimin e alfabetit. Nismën e merrte njëri organ, tjetri e vazhdonte dhe e përpunonte derisa krijohet një fizionomi e qartë se çfarë alfabeti i duhej gjuhës shqipe dhe popullit shqiptar.

Të gjitha nismat e marra nga patriotët shqiptarë dhe shtypi në atë kohë dhe më vonë për këtë çështje, do të shërbenin jo vetëm për elektrizuar opinionin e kohës, të jashtëm dhe të brendshëm, por do krijonin edhe kushte favorizuese që shqiptarët të mblidheshin dhe t’i jepnin fund kësaj odiseje, e cila mori fund 100 vjet më parë, në vitin 1908 në Manastir.

---

<sup>1</sup> *Kombi*, nr. 31, 28 mars 1907.

Gjatë një periudhe 30-vjeçare (1888-1908), qarkulluan me dhjetëra organe brenda dhe jashtë vendit, të cilat thithën firma të fuqishme të patriotëve shqiptarë në shtypin e tyre për të rrahur këtë çështje, por edhe për të dhënë edhe mendime për zgjidhjen e këtij problemi kaq jetik për gjuhën tonë. Nëpërmjet artikujve që u botuan dhe me alfabetet që përdorën në faqet e tyre, ata përgatiten një opinion të shëndoshë që ndihmoi Kongresin e Manastirit për të hartuar alfabetin që kemi sot.

Historikisht shtypi ka qenë në ballë të përpjekjeve për një alfabet të njësuar, si dhe ka ndikuar për të përshpejtuar zgjidhjen e tij. Përveç penave me influencë, që do të prononcoheshin me artikujt e publikuar për këtë çështje, si Çajupi, Asdreni, A. Xhuvani e ndonjë tjetër, do të veçonim edhe drejtuesit e gazetave dhe të revistave që do t'u japin tonin organeve të tyre për këtë problem, si F. Konica, V. Dodani, M. Frashëri, Sh. Kolonja, S. Peci etj. Ata do të kritikojnë përdorimin pa kriter të alfabeteve nga pararendësit dhe bashkëkohësit, duke u dhënë përparësi përdorimit të një sistemi shkrimor për të gjithë shqiptarët.

Në gjysmën e dytë të shek. XIX kemi dy pamje: së pari kemi hartimin e alfabetit të Stambollit, i cili pati fillimisht shumë përkrahës dhe sipas Asdrenit ishte “*Agim për shqiptarët*”. Ndërsa pamja e dytë, ajo që do të sundojë deri në mbledhjen e Kongresit të Manastirit zbulonte kundërshtarët e alfabetit të Stambollit, të cilët në organet e tyre trumbetonin një variant tjetër alfabeti, por gjithnjë mbështetur në atë latin. Gjithashtu në dy pamje paraqiteshin edhe parimet që do të zbatoheshin për alfabetin e shqipes: të parët ishin për parimin që *një fonemë të paraqitej me një grafemë*, që priu alfabeti i Stambollit, ndërsa të dytit ishin për parimin që *mungesat e alfabetit latin t'i plotësonin me grafema dyshe*, në ballë të të cilit qëndroi alfabeti i “Albanisë” së F. Konicës dhe ai i shoqërisë “Bashkimi”. Ky sistem u përkrah më shumë se ishte praktik në të shkruar dhe në botime. Edhe Pedersenin, një filolog i shquar, në një letër që i dërgonte “Albanisë” shprehte mendimin se sistemi me shkronja dyshe mund të përmirësohet derisa të kënaqen të dy palët.

“*Shqipëtari*” i Bukureshtit (1883-1903) që zbatoi alfabetin latin por duke ndjekur për disa shkronja grafine rumune, u jepte rëndësi shkrimeve shqipe për të cilat kishte nevojë Shqipëria. Armiqtë kërkonin që të mos shkruanim në gjuhën amtare, prandaj në këtë situatë gazeta lëshonte thirrjen: “*Shqipëtarë, ay që do kombin dhe mëmë dheun e tij, e*

*para e punës, është të kërkojmë hartra në gjuhën shqipe.”*<sup>2</sup> “*Shqipëtari*” është ndër organet e para të fundit të shek. XIX, që kërkoi një alfabet me bazë latine dhe do të ndiqet nga “*Shqipëria*” e Bukureshtit, “*Albania*”, “*Kombi*”, por edhe nga “*Shqipëria*” e Egjiptit, “*Shpnesa e Shqypnisë*” etj. Megjithëse sistemi shkrimor i kësaj fletoreje nuk pati jehonë të gjerë, kriteret e zbatuara i ndeshim edhe në organet e tjera të kësaj periudhe.

Shtypi i kohës kishte marrë përparësi, se ishte i vetmi vend, ku shqiptarët mund të shfaqnin hapur mendimet e tyre në fushën e kulturës dhe në rastin konkret për alfabetin e përbashkët të gjuhës shqipe. Dhe organet vijjnë njëri pas tjetrit.

Faik Konica në revistën “*Albania*” (1897-1909), në këtë tribun të publicistikës shqiptare të fundit të shek. XIX dhe fillimit të shek. XX, e rreh gjerësisht këtë problem, duke botuar në revistë shumë artikuj, diskutime e letra, disa prej të cilave shkruar nga ai vetë, në të cilat trajtoheshin probleme me vlerë, duke bërë propozime interesante, duke miratuar dhe kundërshtuar shumë çështje të ngritura këtu, si dhe në organe të tjera. Kërkohej që zgjidhja e këtij problemi, si në rrafshin teorik, ashtu edhe në atë praktik, të kishte një përfundim sa më racional, shkencor dhe të përgjithshëm. Zgjidhjen e çështjes së alfabetit Konica e quante një çështje kombëtare dhe letrare.<sup>3</sup>

Një polemikë e ndezur u zhvillua në shtyp kundër alfabetit të Stambollit. Me një duf të paparë, Konica kritikonte këtë sistem shkrimor që sipas tij “i jep gjuhës një hije të egër.”<sup>4</sup> Kritika pati edhe nga organe të tjera, por në krye qëndronte “*Albania*” e Faik Konicës, e cila në asnjë shkrim nuk njohu pajtim, por kritikë. Arshi Pipa e portretizonte kështu F. Konicën për kritikën që bënte: “Aristokrat edhe kur shante, ashtu si ai vetë dinte të shante... Kishte një faj nuk mund të shihte tjetërkënd sipër vehtes, bile as pranë vehtes. Po në të vërtetë cili mund t’i afrohej?”<sup>5</sup> Megjithatë stafi i revistës shprehte mendimin se “çështja e shkrimit të shqipes nuk mund të zgjidhej veçse ditën kur në Shqipëri do të ndodhë

<sup>2</sup> “Abetarja shqip”, *Shqipëtari*, Bukuresht, nr. 2, 7 janar 1899

<sup>3</sup> F. Konica, “Problemi i shkrimit të shqipes në vend të vërtetë të tij”, *Albania*, 1904, nr. 12, f. 234

<sup>4</sup> F. Konica, “Abetari shqip”, *Albania*, 1902, nr. 1, f. 24.

<sup>5</sup> A. Pipa, “Faik Konica aristokrat edhe kur shau...”, *Gazeta shqiptare* (Milosao), Tiranë, 17 gusht 1908, f. VI.

një ndryshim politik.”<sup>6</sup> Dhe F. Konica mendonte fillimisht se alfabeti i tij do të bëhej i përgjithshëm, duke i dhënë përparësi përhapjes së alfabetit latin.

Në këtë periudhë vazhdonin të dilnin edhe fletore të tjera me karakter politik dhe kulturor, organe që në plan të parë vinin, kryesisht, njësimin e alfabetit. Në këtë kohë fondit të publicistikës shqiptare iu shtua edhe një organ tjetër, “Shqipëria” (1897-1899), që dilte në Bukuresht, në zemrën e përdorimit të alfabetit të Stambollit dhe drejtohej nga Visar Dodani. Që në numrat e parë, kjo fletore trajtoi çështjen e alfabetit, që në atë kohë kishte marrë një hov të ri, duke u pasqyruar, në gjitha botimet shqipe. Motoja e kësaj fletoreje ishte që të pasqyronte në një sfond sa më qartë domosdoshmërinë e gjuhës së një kombi, por edhe të shkronjave të tij që transmetonin brez pas brezi diturinë e një populli.

Çajupi botoi një shkrim të gjatë të “Shqipëria” e Bukureshtit, në pesë numra<sup>7</sup>, shkruar me kompetencë dhe i mbushur me indinjatë e zemërim ndaj armiqve të popullit shqiptar. Situata nuk ishte e thjeshtë. Kishte zënie, mëri, grindje, për të cilat Çajupi bënte thirrje që përpara atdheut duhet të liheshin mënjanë. Artikulli pati jehonë pozitive në gjithë shqiptarët, kryesisht të mërgimit.

Zëri i “Shqipërisë” së Bukureshtit nuk mbeti i heshtur. Do të jenë disa organe që do t’i përgjigjen gazetës në atë kohë, por dhe më vonë, si: “Albania” e Konicës, “Ylli i Shqipërisë”, “Shqipëria” e Egjiptit, “Kombi” “Dashamiri”, “Korça” etj. Ideja që shumë e mirë. “Shqipëria” e Bukureshtit nuk kishte si qëllim më vete që të bëhej iniciatore për këtë problem, por dëshira e saj ishte që t’i jepej një zgjidhje atij.

Shkrimet kushtuar alfabetit të shqipes, me kalimin e viteve, po merrnin gjithnjë e më shumë përparësi në organet e kohës. Shahin Kolonja, më 1903, në të përkohshmen “Drita” botoi një shkrim problemor me titull “Shkrimi, këndimi, abetare e gjuhës sonë”<sup>8</sup>, ku veçonte tre faktorë që do të ndihmonin në përhapjen e shkrimit dhe të këndimit të shqiptarët e konkretisht:

<sup>6</sup> T.S.B, “Çështja e shkrimit të shqipes” (frëngjisht), *Albania*, 1897, nr. 7, në F. Konica, “Mendime gjuhësie” nga K. Jorgaqi, Tiranë, 2007, f. 89.

<sup>7</sup> A. Z. Çajupi, *Për alfabetin*, “Shqipëria”, nr. 49, 59, 51, 52, 53 shtator-nëntor 1898.

<sup>8</sup> Sh. Kolonja, “Shkrimi, këndimi, abetare e gjuhës shqipe”, *Drita*, Sofie, nr. 32, 5/18 nëntor 1903, nr. 33, 21 nëntor 1903 dhe në *Alfabeti i gjuhës shqipe dhe Kongresi i Manastirit*, Tiranë, 1972, f. 177-180.

- një palë shkronja të mira e të plota për gjuhën shqipe;  
- vjersha të bukura e mësimet të mira e të lehta që të merren vesh e të pëlqehen;

- njerëz që t'i përhapin.<sup>9</sup>

Sh. Kolonja kërkonte që alfabeti i shqipes të mos kishte asnjë lidhje dhe asnjë përngjasim me sistemet shkrimore të tjera. Për autorin “e mira e të mirave do të qe që gjuha shqipe të kishte një palë shkronja të veçanta, të mos kishin afërim as me shkronjat greko-latine, as me të tjerat, siç janë të armenëve.”

Shtypi shqiptar në Rumani aktivizohet së tepërmi. Organet “Ylli i Shqipërisë” (L’etoile albanaise), “La Renaissance albanaise” (Përlindja shqiptare) kritikonin përdorimin e shumë alfabeteve për gjuhën shqipe, të cilat pengonin zhvillimin e saj, dhe bënë thirrje që të kishim një alfabet për të gjithë me bazë latine.

Dy organe njëri pas tjetrit, në Kajro “Besa” (1904), me kryeredaktor Thoma Avramin dhe “Pellazgu” (1907), ngritën me forcë çështjen e bashkimit të forcave demokratike në luftë kundër armiqve të popullit shqiptar, duke kërkuar që shqiptarët të kishin një alfabet të vetëm që mbështetej në atë latin.” Alfabeti i “Besës”, - shkruan I. Zamputi, - është pararendësi më i vjetër dhe më i afërt me alfabetin tonë të sotëm, nga i cili ndryshon vetëm në tri shkronja.”<sup>10</sup>

Përparësi po fitonte alfabeti i shoqërisë “Bashkimi”. Jehona e tij kishte arritur edhe në brigjet e Mesdheut, në kontinentin afrikan, të cilin pas disa numrash do ta përqafonte edhe “Pellazgu”.

Por shtypi shqiptar depërtoi edhe në SHBA me botimin e gazetës “Kombi” në qershor të vitit 1906 me drejtues atdhetarin Sotir Peci. Që në numrat e parë gazeta deklaronte se pëlqente alfabetin latin për shqipen dhe në veçanti alfabetin e shoqërisë “Bashkimi”. Duke mos e konsideruar këtë problem të zgjidhur, por një punë që mund ta kryenin vetëm njerëz të ditur, që “të jenë gllsollogë që të mundin pas diturisë së tyre të fillojnë një sistem me themeli e pa ligjet etimologjisë dhe të zërave”<sup>11</sup>. Për “Kombin kjo është një detyrë urgjente një çështje që duhej zgjidhur. Këtu gjejnë vend edhe disa konsiderata të Fan Nolit, i cili ishte shumë i mërzhitur nga gjendja ekzistuese, pasi nuk po gjendej ndonjë rrugë për të

<sup>9</sup> Po ai, po aty, f. 171.

<sup>10</sup> I. Zamputi, “Kontribut për historikun e alfabetit tonë”, *BSSHSH*, Tiranë, 1957, nr. 1, 191.

<sup>11</sup> *Kombi*, Boston, nr. 11, 23.06. 1906.

dalë nga kaosi që ekzistonte në shkrimin e shqipes. “Për të bërë vjersha, - theksonte Noli, - është shumë punë e kollajshme, vetëm një kalem duhet, po me ç’shkronja? me të Stambollit, me të Bashkimit, me të Dijes, me të De Radës apo... mjaftni se na u mërzi jeta...Po, kur s’u morëm vesh për abecenë, që është e para e punës, si do të merremi vesh më tutje?”<sup>12</sup>

Gazeta “Kombi” botoi edhe artikuj të marrë nga shtypi shqiptar i kohës, si nga “Shqipëria” e Kajros, e cila u shtronte pyetjen shqiptarëve se cili alfabet u pëlqente dhe përse. “Kombi” kërkonte një alfabet të ri, “i cili të jetë më i sosur.”<sup>13</sup> Po në këtë numër “Kombi” hapte kolonat e saj që të shkruanin për alfabetin e shqipes. Më pas gazeta kërkonte që alfabeti të ishte i shkurtër dhe të mos kishte shkronja që nuk gjendeshin në asnjë shtypshkronjë.<sup>14</sup>

Gjuhëtari Aleksandër Xhuvani, i cili i ndiqte nga afër problemet që ngriheshin për zgjidhjen e kësaj çështjeje, jepte edhe ai mendimet e tij në shkrimet që botoi ose ribotoi për këtë çështje në shtypin shqiptar të Londrës, të Raguzës, të Magagës (Egjipt), të arbëreshëve të Italisë, por edhe të “Kombi” i Bostonit<sup>15</sup>, duke miratuar ose duke kundërshtuar propozimet e bëra. Ai nuk e pëlqente dhe nuk e pranonte që diskutimi i këtij problemi të bëhej në një kongres, i cili për autorin ishte një zgjidhje e pavend. Prandaj për Xhuvanin ata që pengonin zgjidhjen e kësaj çështjeje ishin edhe faktorët subjektivë. Kështu duhet të na karakterizojë mirëkuptimi dhe toleranca. *Due të them*, - shkruante A. Xhuvani, - *se po të kemi pak vullnet të mirë po t’i lamë mënjanë arsyet e simpathiat vetvetore, cmirin e nakarin njerëzor untimin shqiptar, çështja e abesë zgjidhet udobisht.*<sup>16</sup>

Zgjidhja për A. Xhuvanin ishte që të merrej një alfabet ekzistues, i cili t’i kishte qëndruar kohës dhe të ishte i arsyeshëm. Për këtë pëlqente alfabetin e shoqërisë “Bashkimi”. Ai kundërshtonte simbiozën e alfabetit latin, grek dhe sllav. Alfabeti për të, ashtu si edhe për autorët e tjerë pararendës Konica, Çajupi, Sh. Kolonja etj., duhet të kishte këto cilësi:

- të mësohej dhe të shkruhej lehtësisht prej çdo shqiptari;
- të kishim një alfabet të thjeshtë, jo të përzier;

<sup>12</sup> Kombi, nr. 99, 28.08.1998

<sup>13</sup> Shih:J. Kastrati, “Lufta për njësimin e alfabetit shqip në vitet 1878-1905”, në *Alfabeti i gjuhës shqipe...* f. 86.

<sup>14</sup> *Kombi*, nr. 30, 20 mars 1907.

<sup>15</sup> *Kombi*, nr. 39, 29 maj 1907.

<sup>16</sup> A. Xhuvani, “Dy fjalë për abenë”, në *Alfabeti i gjuhës shqipe...* f. 203.

- të përdorej më me lehtësi prej të huajve.

Duke e lidhur me faktorë historikë, për Xhuvanin më e arsyeshme dhe më e domosdoshme për shqipen ishte që ajo të kishte alfabetin e vet që t'i përshtatej "sa më mirë natyrës së gjuhës së vet." Gjithashtu në letërkëmbimin e tij A. Xhuvani shfaqte edhe ndonjë mendim për Kongresin e Manastirit që ai quante "Bashkëndenja e Manastirit."

"Kombi", i cili i ndiqte për së afërmi ngjarjet që ndodhnin lidhur me zgjidhjen e çështjes së alfabetit të njësuar të shqipes, jepte edhe disa njoftime me interes, si për një kongres që mund të mbahej në Zvicër, më pas për një kongres në Bukuresht dhe, së fundi, për një marrëveshje të arritur në mes të tri organeve kryesore të kohës "Drita", "Dashamiri" dhe "Kombi."

Asnjë organ nuk donte të që ndronte pasiv ndaj këtij problemi. Secili donte që të hynte në historinë e kësaj fushe me ndonjë propozim konkret. Nëse "Shqipëria" e Bukureshtit hapte kolonat e saj për të diskutuar këtë çështje dhe sipas saj më këtë problem do të merreshin njerëzit e ditur, por njëkohësisht ftonte edhe organet e tjera të vepronin në këtë mënyrë. 10 vjet më pas, "Shqipëria" që dilte në Magaga të Egjiptit, propozonte edhe ajo që me këtë problem të merreshin njerëzit e zgjedhur, puna e të cilëve do të vazhdonte me një kuvend ose kongres, që me pëlqimin e shumicës do të miratonin alfabetin e përbashkët të shqipes.

Përsëri kemi propozime të reja. "Shqipëria" e Kajros, më 15 shkurt 1907 hapte diskutimin me dy pyetje që shtronte:

1. Cila abe ju pëlqen?
2. Përse ju pëlqen kjo abe?<sup>17</sup>

Ndërsa në një shkrim të botuar në Kalendarin e shoqërisë "Dija", theksohej se përdorimi i shumë alfabeve po i sillte shumë dëm gjuhës shqipe dhe propozohej që përfaqësuesit e katër alfabeve kryesore të përdorura në atë kohë: alfabeti i autorëve të vjetër, i Stambollit, i "Bashkimit" dhe i "Agimit" duhet të gjenin rrugën për një alfabet të përbashkët që të pranohet nga të gjithë shqiptarët.<sup>18</sup>

\* \* \*

Por nuk qëndroi larg këtij problemi edhe shtypi i huaj, veçanërisht ai arbëresh, i cili në atë periudhë shënoi një ngritje të veçantë. Organet që

<sup>17</sup> *Shqipëria*, Kajro, 15 shkurt 1907, f.4

<sup>18</sup> Shkëmbi (Pseud.), "Kalendari i shoqërisë", *Dija*, Vjenë, 1908, f. 3.

dolën në këtë 30-vjeçar, si “Nazione albanese” (1897-1924), “La nuova Albania” (1889-1904), “Flamuri i Shqipërisë” (1904), “La questione albanese” (1905) etj., e trajtuan gjerësisht këtë problem, veçanërisht “La Nazione albanese”, e cila pati një jetë më të gjatë, duke qarkulluar për 27 vjet. Do të jetë vetë Anselmo Lorecio që do të marrë pjesë në këtë diskutim. Në shkrimin “L’alfabeto albanese” ai kërkoi që të mos humbet kohë me diskutime të pambarim dhe pa fryt, por t’i jepet një zgjidhje këtij problemi se përçarja për gjuhën sjell edhe përçarje kombëtare<sup>19</sup>. Po në këtë gazetë autorë të ndryshëm gjetën mundësi të botojnë shkrime për shqetësimet që kishin. Në një letër që boton ky organ, më 1897, autori i saj shpreh friken se në përdorimin e shqipes me shkronja greke mund të fshihet ndonjë çështje me karakter politik dhe në vend të ngjyrës mund të derdhet gjak. Në këtë organ, krahas çështjeve të tjera për alfabetin e shqipes, shprehet edhe preferenca, kryesisht për dy sisteme shkrimore atë të “Bashkimit” dhe të “Agimit”, duke parapëlqyer nga disa autorë atë të “Agimit”. Arrihet deri në atë pikë sa që kërkohet të bëhet një bllok në përkrahje të alfabetit të “Agimit”. Por G. J. Më rturi në një shkrim prej 3 faqesh me titull “Question ortografic” vlerëson shoqërinë “Bashkimi”, “Albaninë” e Konicës dhe “Shqipëtarin” e Bukureshtit, të cilët të tre kanë një sistem shkrimor, pa shenja diakritike dhe propozon mënyrën se si mund të zhduken ndryshimet në mes të tri alfabeteve<sup>20</sup>. Për hir të interesit të përgjithshëm m duhej të gjenin një gjuhë të përbashkët, edhe duke sakrifikuar diçka.

Ndërsa “La Nuova Albania” që dilte në Napoli, duke mos u pajtuar me sëmundjen e kohës që sipas dëshirave të përdorej çfarëdo alfabeti, bënte thirrje që të organizohet një mbledhje që të hartojë një alfabet të pëlqyer prej të gjithëve, por vetë ajo pranon alfabetin e shoqërisë “Bashkimi”<sup>21</sup>. “Flamuri i Shqipërisë”, një revistë e përdyjavshme politike, shoqërore dhe kulturore, e cila qarkulloi në vitin 1904, që në numrin e parë trajton çështjen e alfabetit të përbashkët të shqipes, ndërsa në një shkrim tjetër të po atij numri, autori ngrre domosdoshmërinë e hartimit të një alfabeti të vetëm që “të mos shihen aq letra sa libra janë të shtyposurë.” Zgjidhja e alfabetit të njësuar për stafin e revistës mund të

<sup>19</sup> A. Lorecio, “L’alfabeto albanese”, *La Nazione albanese*, 15 gennaio, 1903, nr. 1, f. 2-3

<sup>20</sup> G. J. Merturi, “Question ortografic”, *La Nazione albanese*, 30 aprile, 1904, nr. 8, f. 4-6

<sup>21</sup> *La Nuova Albania*, Napoli, 2 luglio 1898, nr. 5.

arrihet kur të hapen shkolla në gjuhën amtare dhe kur njerëzit të jenë të mësuar dhe të flasin ashtu siç duhet. Edhe vetë Skiroi nuk zbatoi në revistë asnjë nga variantet me të cilat kishte shkruar veprat e veta. Të gjitha variantet e përdorura në këtë organ janë mbështetur në alfabetin latin, pa huazuar asnjë shkronjë nga alfabetet e tjera. Për shkronjat që i mungonin alfabetit latin përdori dyshkronjëshat që i formon me ndihmën e bashkëtingëlloreve *h, j, ç*.

Karakteristikë e sistemeve shkrimore të zbatuara nga arbëreshët e Italisë ishte përdorimi i alfabetit latin-italian, duke hequr, me ndonjë përjashtim, të gjitha shkronjat greke. Të gjitha këto krijuan kushte për të nxitur opinionin mbarëkombëtar për të realizuar njësimin e alfabetit të shqipes.

\* \* \*

Shtypi i kohës, veçanërisht për një periudhë 30-vjeçare, duke parë situatën kaotike dhe shqetësuese për zgjidhjen e këtij problemi, dha alarmin për përshpejtimin e përpjekjeve duke u bërë zëdhënësi më aktiv për njësimin e alfabetit të shqipes.

Dhe roli i tij që i madh dhe i rëndësishëm, veçanërisht në agim të shek. XX, kur deri në atë kohë kishin shpërthyer një lumë alfabetesh. Ishte krijuar një atmosferë e ndezur që kjo çështje të zgjidhej me përparësi, meqë tashmë ishte bërë një kërkesë objektive. Shtypi i kohës u bë tribunë dhe kërkoi që të përdoreshin të gjitha mjetet diplomatike, por edhe luftarake, për të zgjidhur këtë çështje kaq jetike për kulturën tonë. “Pa të kërcasim edhe ne njëherë dhëmbët kundër armiqve, - thuhej në një artikull, - t’u tregojmë edhe hutat, të shohëm se do të guxonjën të sillenë pas kësaj mënyre.”<sup>22</sup>

Koha kërkonte veprim. E kështu ndodhi 100 vjet më parë, më 1908, me Kongresin e Manastirit, i cili zgjidhi përfundimisht alfabetin e njësuar të gjuhë shqipe, duke i dhënë fund një herë e përgjithmonë atij pështjellimi që ekzistonte deri në atë kohë për shkrimin e shqipes. Realiteti i kohës dhe i mëvonshëm vërtetoi drejtësinë e kësaj zgjidhjeje historike për kulturën e gjuhën e popullit tonë, duke miratuar alfabetin që kemi sot.

---

<sup>22</sup> P. Shkaku i të mos mbrothësuarit të shkronjave shqip në Shqipëri, “Kalendari kombiar”, Sofie, 1905, në *Mendimi politik e shoqëror i Rilindjes Kombëtare Shqiptare*, I, Tiranë, 1971, f. 281.

